

**AKADEMIA E FORCAVE TE ARMATOSURA**



**MBËSHTETJA ME ZBULIM E  
OPERACIONEVE  
TË INTESITETIT TË ULËT**



**KOLONEL ARJAN HILAJ**

**TIRANE, 2018**

**MBËSHTETJA ME ZBULIM E  
OPERACIONEVE TË INTESITETIT TË  
ULËT**

Autoreferat i paraqitur në

Akademinë e Forcave të Armatosura, Tiranë

Në përputhje të plotë

me kërkesat

Për gradën “Doktor”

Përgatitur nga

MSc. Kolonel Arjan Hilaj

Udhëheqësi Shkencor

Prof.Dr. Kristaq Xharo

## **PËRMBAJTJA**

HYRJE.....	4
LITERATURA .....	7
METODOLOGJIA .....	8
KUFIZIMET.....	9
KREU I. PËRCAKTIMI I OPERACIONEVE ME INTESITETIT TË ULËT .....	10
KREU II: ROLI, PARIMET DHE BURIMET E ZBULIMIT NË OPERACIONET E INTENSITETIT TË ULËT.....	13
KREU III: PËRGATITJA ZBULUESE E AMBJENTIT OPERACIONAL NË OIU .....	15
KREU IV : ANALIZA E ZBULIMIT NË OPERACIONET E INTESITETIT TË ULËT .....	19
KREU V: ZHVILLIMI E MODERNIZIMI I KAPACITETEVE ZBULIM PËR OPERACIONET OIU .....	20
KREU VI. PËRFUNDIME.....	24
KREU VII. REKOMANDIME .....	25
BIBLIOGRAFIA .....	27
PUBLIKIME TË AUTORIT .....	36
CURRICULUM VITAE.....	37

## **HYRJE**

Shtysa për ndërmarjen e një studimi të tillë bazohet kryesisht në eksperiencën disa vjeçare të grumbulluar gjatë shërbimit në Drejtorinë e Zbulimit në Shtabin e Përgjithshëm të FA, vite të cilat kanë shërbyer për të njohur, cekur por në një mënyrë edhe për të ndikuar aty ku kam patur mundësi, në mënyrat se si shërbimi i zbulimit mbështet forcën e armatosur në spektrin e operacioneve.

Ngjarjet e 11 shtatorit 2001 në SHBA, kur grupe terroriste të organizates Al Kaeda sulmuan disa objekte domethënës në truallin amerikan me pasojë mijëra viktima të pafajshme, shënuan një pikë kthese, ashtu si dhe për shumë shtete të tjera në botë, për mënyrën e trajtimit dhe përballjes me rreziqet asimetrike, deri atëherë në më të shumtën e rasteve lënë si çështje e trajtuar nga ana e organeve të zbatimit të ligjit. Si e këtillë lindi edhe nevoja që Forcat e Armatosura Shqiptare të përgatiteshin për mbrojtjen nga rreziqe të tilla.

Gjatë stërvitjes së Shtabit të Përgjithshëm të koduar « Shqiponja 02 », skenari i të cilës përfshinte përveç kryerjes së operacionit mbrojtës konvencional edhe rastet kur grupe terroriste me veprim në thellësi të vijave të mbrojtjes sonë kërkonin një përgjigje të përshtatshme, përballi personelin e Drejtorisë së Zbulimit me dicka që nuk ishte e përgatitur më parë. Mungonte një dokument i shkruar i cili të drejtonte veprimtarinë e shërbimit të zbulimit për të identifikuar, grumbulluar, analizuar dhe shpërndarë informacion tek konsumatori. Për rrjedhojë përgjigjia ndaj një kërcënimi të tillë në këtë stërvitje ishte diçka midis improvizimit dhe përdorimit të metodave të njohura konvencionale.

Në vitin 2004, Drejtori i Zbulimit ushtarak në SHPFA incioj në bashkëpunim me Komandën e Forcës Tokësore, ngritjen e një grupi pune, pjestar i të cilit isha edhe unë, për zhvillimin e një studimi i cili do të shërbente si bazë për kryerjen e ristrukturimit por edhe të modernizimit të shërbimit të zbulimit në forcën tokësore. Studimi i cili megjithëse merrte në konsideratë praktikat më të mira të njohura nga shtete të mëdha (p.sh. SHBA) nuk u mor parasysh me arsyetimin së gjetjet e grupit të punës ishin “të parakohshme” dhe “futuristike”. Fakt është së ristrukturimi i shprehur ndryshe «shkurtim forcash dhe mjetesh » drejtohet gjithmonë nga

prania e burimeve financiare dhe jo nga kapacitetet që kërkohen e që dalin nga misioni kushtetues.

Për pasojë ristrukturimi i kryer në atë kohë i kompanisë së zbulimit të FT ishte i mangët dhe nuk mund të plotësonte misionin, të paktën për operacionet e intensitetit të ulët.

Stërvipte në kuadër të SHP por edhe të llojeve të forcave, me objekt luftën kundër terrorizmit (një nga format e luftës së intensitetit të ulët), u kryen por në kushtet e mungesës së një baze doktrimore në të cilën të mbështetej stërvipta dhe për rrjedhojë edhe detyrat që duheshin kryer mbetet subjekt dyshimi për efektivitetin e tyre në pikpamje të mbështetjes me zbulim.

Një sinjal i mirë u shënua në vitin 2007, kohë në të cilën SHPFA nxori në qarkullim “Planin Afatgjatë të Zhvillimit të Forcës së Armatosur 2020”, në të cilën përcaktohej së :

« Zbulimi Ushtarak, të kryejë operacione në të gjithë spektrin e misioneve konvencionale dhe jo konvencionale dhe të jetë në gjendje të sigurojë një mbulim të gjerë shumë disiplinor të hapësirës së fushëbetejës në (kohë reale) e në të njëjtën kohë, të mbështesë operacionet për sigurimin e forcave të veta ».<sup>1</sup>

Ky plan, i cili do të hapte një horizont të ri për shërbimin e zbulimit në pikëpamje të zhvillimit doktrinor, pajisjeve, stërvipteve dhe të personelit, ngeli në letër duke i lënë zhvillimin e kapaciteteve zbulim rastësisë, mungesës së interesit dhe në rastin më të mirë « pamjaftueshmëri kronike » të burimeve financiare ndërkohë që pranohej botërisht nga vendimarrësit së një forcë e armatosur më e vogël në numër domosdoshmërisht duhet të ketë një shërbim të aftë zbulimi.

Përgatitja dhe botimi nga drejtorja e zbulimit e doktrinës së zbulimit MP-2.0<sup>2</sup>, ishte përpjekja e fundit e cila sadopak do të shërbente për të kanalizuar në drejtimin e duhur shërbimin e zbulimit, në një kohë që Forca e Armatosur po kalonte një

---

1 Shtabi i Përgjithshëm i FA, **Plani Afatgjatë i Zhvillimit - 2020**, (2007), Qendra e Shtypit dhe Botimeve Ushtarake: 2007

2 Hilaj, A, Haxhiaj I, Bërzani R, **MP-2-0, Doktrina e Mbështetjes me Zbulim të Operacioneve të Përbashkëta**, (2008), Qendra e Shtypit dhe Botimeve Ushtarake: 2008

ristrukturim tjetër. Në të njëjtën vijë pune ishin edhe përfundimet e grupit të punës të ngritur për këtë qëllim, të cilët si konkluzion nxorën rishikimin e strukturave të deriatëhershme, bashkimin e burimeve të zbulimit ( të ndara deri në atë kohë) si dhe ripërcaktimin e rolit, detyrave dhe misionit të shërbimit të zbulimit në tre nivelet e luftës por edhe në spektrin e operacioneve. Dështimi për zbatimin e gjetjeve të grupit të punës pati si rrjedhojë një dobësim akoma më të madh të zbulimit ushtarak në përmbushjen e misionit të tij, e reflektuar kjo në të gjithë strukturën e tij, buxhetimin për pajisje dhe stërvitje dhe rolin e zënë në vendimmarrjen ushtarake.

Ristrukturimi i vitit 2011 i ka dhënë goditjen e fundit këtij funksioni shumë të rëndësishëm të luftimit kur nga një nënrepart autonom i komandës së FT kaloi si pjesë përbërëse e batalionit të trupave komando. Logjika e ndjekur për kryerjen e një veprimi të tillë është e paqartë dhe pasoja është që për këto lloj operacionesh Forca e Armatosur shqiptare është e pa përgatitur.

**Qëllimi i studimit:** të analizojë mundësitë aktuale dhe të japë opsione për organizimin, pajisjen dhe përdorimin në nivel taktik dhe operacional të shërbimit të zbulimit në mbështetje të operacioneve të intensitetit të ulët.

- Objektivi :**
- të përcaktojë cilat janë operacionet e intensitetit të ulët në (OIU) në spektrin e operacioneve ;
  - të krahasojë e të japë një opsion të ri për kryerjen e përgatitjes zbuluese të fushës së luftimit ;
  - të identifikojë dhe tregojë rolin, detyrat, burimet e informacionit dhe arkitekturën e përshtatshme të mbështetjes me zbulim të operacioneve të intensitetit të ulët ;
  - të analizojë, krahasojë e identifikojë ndryshimet që hasen gjatë procesit të kryerjes së analizës së zbulimit në OIU me operacionet konvencionale ;
  - të sigurojë një strukturë analitike për OIU në të cilën të bazohen edhe kurrikulat për edukim dhe trajnim, e cila do të rrisë kapacitetet e shërbimit të

zbulimit për tu përballuar me mjedis operacional OIU ;

- të vleresojë, analizojë dhe tregojë mangësitë në strukturën aktuale të mbështetjes me zbulim të operacioneve OIU dhe të japë një model të ri organizativ, strukturor në nivel taktik dhe operacional të mbështetjes me zbulim.

## **LITERATURA**

Koncepti teorik i kësaj teme është trajtuar në bazë të disa kërkimeve kryesisht në ato pas luftës së II-të Botërore, që trajtojnë luftën e parregullt të njohur ndryshe edhe si lufta e intensitetit të ulët që trajtojnë dhe analizojnë veçanërisht format e shfaqjes, zhvillimit dhe risqet me të cilat përballen shtetet dhe forcat e sigurisë së tyre.

Në përputhje me qëllimin e studimit është bërë një analizë e disa prej formave më të rëndësishme të luftës së intensitetit të ulët siç është kryengritja, terrorizmi dhe kundërkryengritja duke u bazuar në përfundime të nxjerra nga bota akademike por edhe nga praktikuesit dhe pjesëmarrësit në to përfshirë edhe autorin.

Studimet për luftën e intensitetit të ulët në vendin tonë dhe kundërvënien ndaj saj janë shumë të vogla. Para viteve 90, në doktrinat ushtarake lufta e intensitetit të ulët klasifikohet si luftë partizane në shërbim të çlirimit nga pushtuesit apo kolonizatorët. Veçanërisht trupat e zbulimit përgatiteshin e trajnoheshin për të përdorur këtë lloj luftimi në rast ndeshje me shtete armiq. Por mungon në fakt literatura e cila bën fjalë për kundërvënien ndaj një forme të tillë lufte siç është kryengritja apo terrorizmi<sup>3</sup>.

Literatura botërore, kryesisht perëndimore, është shumë e pasur me studime dhe artikuj për luftën e intensitetit të ulët duke qenë së shumë prej tyre ishin fuqi kolonizuese dhe shumë shpejt pas

---

<sup>3</sup> Fakt është se pushteti komunist i instaluar në Shqipëri në vitet e para të jetës vet u përball me forma embrionale kundërvënie si "kryengritja e Postribes" e vitit 1946 prej nacionalisteve vendas ose operacionet klandestine të planëzuara, financuara dhe organizuara nga SHBA-ja dhe Anglia me emigracionin politik shqiptar në vitet 50-të, të cilat dështuan edhe prej ndihmes që agjenti Kim Philby ( Oficer i lartë i zbulimit anglez) jepte në dhënien e informacioneve për KGB-në sovjetike dhe kjo e fundit për simotrën e vet "Sigurimin e Shtetit".

përfundimit të LII-të Botërore u përballën me lufrat për çlirim të vendeve të ashtuquajtura të botës së tretë që në fakt kishte të bënte me përplasjen e dy kampeve dhe ideologjive, asaj perendimore dhe komuniste.

## **METODOLOGJIA**

Ne jemi munduar të shfrytëzojmë të gjithë literaturën, sidomos atë që mendohet së ka lidhje me misionet e tanishme dhe të ardhshme të Forcave të Armatosuara shqiptare dhe kontributin gjithmone e në rritje të tyre në operacione të drejtuara nga NATO, BE apo OKB në teatro të ndryshëm operacional, ku kryengritja dhe terrorizmi janë format kryesore që përdoren nga armiku.

**Analizimi i dokumentacionit** që i referohet literaturës specifike në lidhje me luftën e intensitetit të ulët nëpërmjet leximit. Kjo metodë të lejon të analizosh por edhe të krahasosh, origjinën, zhvillimin e shtrirjen kohore edhe hapësinore të kësaj forme lufte. Burime parësore janë marrë nga punimet e kryera nga kompani “think-tank” të SHBA-së, punimet e analistëve me emër të zbulimit amerikan si Richard Heur, studiuesit e njohur të fenomenit dhe praktikantët e luftës me intensitet të ulët si Frank Kitson, David Galula, David Kilckullen apo John Nagle si dhe qendra e mësimave të nxjerra e Forcave Tokësore të SHBA-së .

**Sintezë** e literaturës së ndryshme ( doktrimore dhe akademike) për të identifikuar qasje të ndryshme, teknika analitike dhe mjete të tjera që mund të përdoren në analizën e zbulimit në OIU.

**Vëzhgimi aktiv** që përqendrohet në vëzhgimin e fenomeneve të shfaqura ndonëse jo të plotë në zonën e operacionit në Afganistan. Nëpërmjet intervistave dhe bisedës me përfaqësues të ushtrisë kombëtare afgane, popullsinë lokale por edhe eksperte të zbulimit nga forcat e koalicionit, analizohen faktorët më me rëndësi për tu marrë në konsideratë në këtë mjedis operacional.

**Metoda krahasuese** nëpërmjet të cilës identifikohen elementet të cilat zbatohen gjatë procesit të kryerjes së përgatitjes zbuluese të fushës së luftimit dhe analizës së zbulimit në operacionet konvencionale dhe krahasohen me elemente të cilat janë të zbatueshme në luftën me intensitet të ulët.



## **KUFIZIMET**

Praktikat e sukseseshme, taktika, teknika dhe procedura (TTP) për mbështetjen me zbulim janë ende subjekt klasifikimi nga shumica e shteteve që janë angazhuar në OIU, kështu që studimi bazohet kryesisht vetëm në shfrytëzimin e burimeve të hapura.

Studimi bazohet gjerësisht në praktikat perëndimore për shkak të sasisë së burimeve me origjinë perëndimore por edhe pamundësisë së shfrytëzimit të burimeve nga shtete që e kanë praktikuar ose praktikojnë atë si Rusia, Kina dhe India [*shen.im. edhe në ato raste si psh.lufta në Çeçeni e rusëve burimi i cituar është perëndimor*].

Në spektrin e operacioneve të intensitetit të ulët janë lënë jashtë shqyrtimi operacionet paqëruajtëse, operacionet e mbështetjes së forcave të sigurisë (Foreign Internal Defense), operacionet e nxitjes së kryengritjes (Irregular Warfare), operacionet e informacionit dhe të Luftës Psikologjike (PSYOPS).

Studimi është i ndarë në 7 kapituj; *Percaktimi i operacioneve me intensitetin të ulët; Roli, parimet dhe burimet e mbështetjes me zbulim të OIU-se; Pergatitja zbuluese e mjedisit operacional në OIU; Analiza e zbulimit në OIU, Përfundime dhe Rekomandime* për zhvillimin dhe modernizimin e kapaciteteve zbulim për operacionet OIU.

## **KREU I. PËRCAKTIMI I OPERACIONEVE ME INTENSITETIN TË ULËT**

**Në kreun e pare** shpjegohet se konfliktet ndërshtetërore që nga viti 1945<sup>4</sup> tregojnë një parapëlqim të shteteve për tu *angazhuar* në konflikte të intensitetit të ulët. Kjo gjë është e mundur pasi edhe arsenalit ushtarak në dispozicion të tyre është faktor pengues për agresorë të mundshëm që të nisnin një konflikt të hapur. Pushtimi i territoreve nuk është më një dukuri. Influenca ose pushteti arrihet nëpërmjet sigurimit të aksesit në burime kyç për arritjen e një pozicioni të favorshëm gjeostrategjik.

Gara në rritje për burime strategjike të pakta, perspektiva në rritje e pa stabilitetit rajonal, fundamentalizmi fetar dhe pabarazia në rritje e rrisin mundësinë e konfliktit në vendet e pazhvilluara dhe ato në zhvillim me pasojë krijimin e turbullirave dhe kryengritjes.

Si rrjedhojë, luftrat e intensitetit të ulët janë bërë një normë e natyrës së luftës në botë dhe për pasojë në mënyrë të pashmangshme pjesë e Sistemit Ndërkombëtar.

Termi Luftë me Intensitet të Ulët, është një sinonim i cili u përdor gjatë fillimit dhe pas periudhës së luftës në Vietnam. Ai u përdor për të zëvendësuar terminologjinë tradicionale të luftës kryengritëse, terminologji kjo e cila simbolizon (në një farë mënyre dështimin e Amerikës gjatë një eksperience të hidhur në Jug-lindje të Azisë). Luftrat e intensitetit të ulët në përgjithësi kufizohen në zona të veçanta gjeografike ose etnike dhe shpesh karakterizohen nga kufizimet në armatim, taktika dhe në nivelin e dhunës.

---

4 Sood K., (1992), *Low-Intensity Conflict: The Source of Third-World Instability*, *Studies in Conflict and Terrorism*, January 1992, Vol.15, Nr.4. f. 233-250

Përkundër faktit të emërtesës 'të ulët' kjo lloj lufte mund të ketë synime të nivelit strategjik.<sup>5</sup>

**Diferenca midis luftrave të intensitetit të ulët dhe atyre me intensitet të mesëm ose të lartë qëndron në objektivat e tyre.** Karakteristikë e veçantë e LIU është asimetria ndërmjet palëve të përfshira në konflikt e njohur shpesh edhe me termin luftë asimetrike. Lufta asimetrike përshkruan taktikat dhe strategjinë e adoptuar për të shmangur fuqinë e kundërshtarit<sup>6</sup>.

Për qëllime të këtij studimi do të merren në konsideratë terrorizmi, kryengritja dhe kundër kryengritja.

Shumica e njerëzve kanë një ide mënyrë apo përshtypje përsa i përket **terrorizmit**, por ju mungon një përkufizim më i saktë, konkret dhe përcaktues i saktë i kësaj fjale. Kjo pasaktësi u ndihmua pjesërisht nga media moderne, pothuajse çdo akt i dhunshëm që perceptohet si i drejtuar kundër shoqërisë - nëse ajo përfshin aktivitetet disidente anti-qeveritare apo të vetë qeverisë, sindikatat e krimit të organizuar, ose kriminelë të njëjtë, trazirat kriminale ose persona të angazhuar në protesta militante, individë, apo kriminelë të vetëm - është etiketuar shpesh 'terrorizëm'.<sup>7</sup>

Terrorizmi, në përdorimin më të pranuar gjerësisht e bashkëkohor të fjalës në thelb, është politik. Ai është gjithashtu pandashmërisht i lidhur me pushtetin, ushtrimin e pushtetit, marrjen e pushtetit, dhe përdorimin e tij për të arritur ndryshime politike. Si i tillë, ai karakterizohet nga disa pika themelore: **ai është i planifikuar, i llogaritur, dhe në të vërtetë një akt sistematik**.<sup>8</sup>

**Kryengritja** është një konflikt i brendshëm – një formë lufte civile, por me një diferencë të dukshme. Në një luftë civile, një vend normalisht është i ndarë në dy pjesë, çdo njëra e pushtuar nga grupe të ndryshme të armatosura nga mbeturinat e forcave të

---

5 Sood, V. K., vep.cit. f.234

6 Thornton, R., *Asymmetric Warfare*, (2007) Cambridge, Polity Press: 2007, p.2.

7 Russell, H, and Sawyer, R., *Terrorism and Counterterrorism: Readings and Interpretations*, (2004), McGraw-Hill/Dushkin: 2004, f.3

8 Po aty, f. 4

armatosura të shtetit të mëparshëm. Sikurse ka theksuar Galula<sup>9</sup>, vazhdimi i luftës shumë shpejt merr formën e një lufte të rregullt<sup>10</sup> si dhe manuali amerikan për kundërkryengritjen FM 3-24, përshkruajnë Kryengritjen si një formë të një lufte revulucionare. Objektivi është që të rrëzojë qeverinë aktuale dhe të marrë kontrollin e saj.

Një kryengritje, për këtë arsye kërkon ndryshimin e qeverisë, dhe kjo e dallon atë nga çdo lloj konflikti të parregullt, si krimi i organizuar dhe terrorizmi ndërkombëtar. Kryengritësit kanë strategji; ata kanë objektiva të qarta politike dhe mënyra të ndryshme për të arritur objektivat e tyre. Krimi i organizuar, qartazi, është parazitik me pak ose jo sens shërbimi vazhdimësie përveç atij të anëtarëve të tij, dhe nuk ka objektiva përveç atyre personale.<sup>11</sup>

Kryengritjet ndërmerren për t'u përballur me forcën qeverisëse dhe për të përmbysur sistemin politik.<sup>12</sup> Megjithëse i rëndësishëm, konflikti i armatosur nuk është faktori kryesor në suksesin e kryengritjes. Ajo është gjeografikisht i limituar/kufizuar. Qendra e saj e gravitetit është sistemi politiko-social dhe karakteri psikologjik i këtij sistemi.

**Kundërkryengritja** është reagimi ndaj kryengritjes i regjimit ekzistues, i cili shpesh është simptomë e paaftësisë për qeverisje të regjimit ose partisë në pushtet. Qëllimi i përpjekjeve kundër kryengritjes është të gjejë e identifikojë shkaqet e kryengritjes, drejtuesit e tij, si dhe strategjinë e përdorur. **Nuk ka një model historik të kundërkryengritjes.** Për të ruajtur kontrollin, regjimi ekzistues duhet të jetë në gjendje të zgjidhë

---

9 Galula, D. *Counterinsurgency Warfare: Theory and Practice* (1964), Praeger/Pall Mall Press: 1964, f.2-3.

10 Nagl J, *Learning to Eat Soup With a Knife: Counterinsurgency Lessons from Malaya and Vietnam*, (2005), University of Chicago Press: 2005, f.24

11 Metz, S, and Millen, R, *Insurgency and Counterinsurgency in the 20th Century: Reconceptualising Threat and Response*, ( 2004) Strategic Studies Institute: November 2004, f. 29

12 Kitson, F, *Low Intensity Operations: Subversion, Insurgency & Peacekeeping* (1971) Faber and Faber: 1971, f.2

shkaqet jo-normale politike, sociale, ekonomike dhe psikologjike të kryengritjes.

Suksesi i kundërkryengritjes varet në cilësinë e drejtuesit, në kredibilitetin dhe aftësinë e tij për të krijuar një fushatë psikologjike të efekshme, për të ulur ndikimin e kryengritësve. Kjo përpjekje kërkon një integrim efektiv ekonomik, politik, informativ, sigurie dhe ushtarak të institucionit të qeverisë.

## **KREU II: ROLI, PARIMET DHE BURIMET E ZBULIMIT NË OPERACIONET E INTENSITETIT TË ULËT**

Në kreun e dytë per rolin, parimet dhe burimet e zbulimit shprehet se përdorimi i Forcave të Armatosura të organizuara sipas modelit të kohës së Luftës së Ftohtë në një mjedis operacional gjithnjë e më shumë të populluar nga forcat e parregullta, **ka nxjerrë në pah problemin e përdorimit të një mjeti të paracaktuar për kryerjen e një serie detyrash për disa detyra të tjera të paparashikuara.**

Për më tej, ky lloj konfuzioni përshkallëzohet më shumë ndërsa objektivat politike përkthehen në strategji, operacione dhe misione taktike për forcat konvencionale që veprojnë në terren. Kjo gjë rezulton në komplikime serioze për personelin e zbulimit të cilëve u kërkohet të përdorin burime të kufizuara në një mjedis operacional shumëdimensional me faktorë kompleks e të shpërndarë.

Sipas John Gentry, luftrat e intensitetit të ulët zakonisht kërkojnë përpjekje të mëdha nga shërbimi i zbulimit, pasi ato zakonisht kanë kohëzgjatje të madhe si dhe kërkojnë adaptime të rëndësishme të të gjithë organizmave të përfshira me kalimin e kohës.<sup>13</sup>

Cikli i zbulimit ndjek një model të përcaktuar katër hapësh që përfshin, *planëzimin, grumbullimin, vlerësimin e analizën* dhe *shpërndarjen*. Nga kjo perspektivë, dy probleme konceptuale

---

<sup>13</sup> Gentry J, (2010), **Intelligence Learning and Adaptation: Lessons from Counterinsurgency Wars**, *Intelligence and National Security*, 2010, Vol. 25, Nr.1, f. 51.

shfaqen kur bëhet fjalë për operacione të intensitetit të ulët. **Së pari**, transferimi, kur është e mundur, i kërkesave për zbulim nga një pikpamje e luftës konvencionale në një mjedis amorf siç janë konfliktet e intensitetit të ulët. **Së dyti** ka të bëjë me identifikimin e informacionit që kërkohet. Këto dy probleme dalin sepse në sistemin e trajnimit dhe edukimit kuadrot e shërbimit të zbulimit përqendrohen në rreziqet tradicionale 'lehtësisht' të dallueshëm, në pikpamje të kërkesave për zbulim të cilat përqendrohen në taktikat e doktrinave të tyre. Edukimi i trajnimit për një mjedis operacional të intensitetit të ulët është modest ose mungon pothuajse fare në institucionet tona arsimore.

Forcat e Armatosura në dy dekadat e fundit e kanë gjetur veten në kryerjen e këtyre operacioneve në kuadër ndërkombëtar, por duhet theksuar fakti se mbështetja me zbulim është fokusuar më shumë në ruajtjen e forcës, për shkak të rolit të përgjegjësive tonë në operacion si dhe numrit të personelit e teknikës së angazhuar në të. Mbështetja me zbulim, kryesisht në operacionet e forcave tona në Irak dhe Afganistan është kryer nga shtabet më të lartë të partnerëve, nga e cila vetëkuptohet sasia dhe cilësia e informacionit të marrë.

Sfidë, ashtu siç përcaktohet edhe më lart, është kryerja e operacioneve të këtij lloji me vete brenda ose jashtë vendit, kur roli i zbulimit është kritik pasi njohja e armikut përbën një nga parimet themelore të operacioneve të bashkuar<sup>14</sup> në të cilin shërbimi i zbulimit i tregon komandantit se me ç' lloj kundërshtari ose grup kundërshtarësh ka të bëjë, çfarë janë në gjendje të bëjnë ata në momentin e dhënë, dhe çfarë mund të bëjnë në të ardhmen.

Në vijim mund të thuhet se edhe përdorimi i disiplinave të ndryshme të zbulimit në operacionet e intensitetit të ulët ridimensionohet për shkak të kushteve që imponon mjedisi operacional, por edhe kërkesat për informacion zbulimi. **Në OIU informacioni i gjeneruar nga HUMINT është kritik për suksesin e operacioneve por jo vetëm.** Rastet në të cilat forcat e sigurisë kanë triumfuar ndaj aktorëve jo shtetërorë kanë treguar aftësinë për

---

14 Hilaj, A, Haxhij, I, Bërzani, R, *MP-2-0, Doktrina e Mbështetjes me Zbulim të Operacioneve të Përbashkëta*, (2008), Qendra e Shtypit dhe Botimeve Ushtarake: 2008, f.2.

adaptim e zhvilluar teknika të reja zbulimi që në mënyrë progresive kanë rritur sasinë e informacionit të grumbulluar. Gjithashtu metodat e grumbullimit të përdorura përfshinë një kombinim të burimeve përfshirë kryerjen e vëzhgimit nga patrullat, vëzhgimin e fshehtë, rekrutimin dhe vendosjen e agjentëve brenda radhëve të aktorëve jo shtetërorë, marrjen në pyetje të të burgosurve si dhe shfrytëzimin e dokumentacionit të kapur.

### **KREU III: PËRGATITJA ZBULUESE E AMBJENTIT OPERACIONAL NË OIU**

Në kreun e tretë siç përmendet në manualin<sup>15</sup>, *Përgatitja Zbuluese e Luftimit* është një metodë që ndihmon në përcaktimin e Kursit të Vepimit më të mirë të forcave tona dhe përpiqet të tregojë sesi terreni, moti dhe armiku në një zonë të dhënë operacioni, mund të ndikojnë në kryerjen e operacionit të forcave tona. **PZL e kryen këtë gjë nëpërmjet dhënies së një strukture për organizimin e të dhënave dhe nxjerrjen e mangësive në të dhëna zbulimi.**

Si metodë për grumbullimin dhe organizimin e të dhënave, PZL-ja në përdorim është e saktë. Megjithatë duhet thënë se ajo i përshtatet kushteve kur veprohet në një terren të hapur dhe kundër një armiku relativisht të njohur. PZL-ja e tanishme minimizon rolin e elementëve të një operacioni urban – terrenin nëntokësor, ndërtesat, infrastrukturën dhe njerëzit – duke i konsideruar ato si “faktorë të tjerë” me ndikim në operacion. **Duke qenë se këto elemente minimizohen, PZL-ja e tanishme nuk i trupëzon ndikimet e mundshme në operacion në vlerësimin e shtabit. Elementët “ e tjerë” analizohen si “ ndikime të fushës së luftimit”.** Ato zakonisht nuk integrohen gjatë identifikimit të armikut, analizës së tij ose përcaktimit të zonës së interesit.

Lufta e intensitetit të ulët karakterizohet nga një zhvillim i saj në zonat urbane e cila e bën atë një nga llojet e vështira të luftimit për një forcë konvencionale. Përcaktimi i një zone urbane është i vështirë për shkak të kompleksitetit të gjërave në përbërje të saj p.sh., numri relativisht i madh dhe i shumëllojshëm i ndërtimeve

---

15 Hilaj, A, *Përgatitja Zbuluese e Luftimit*, (2004), Qendra e Shtypit dhe Botimeve Ushtarake: 2004

mbi dhe nëntoksore por ajo çka është më kritike është vete popullata e cila me vetë prezencën e saj shton kompleksitetin e një operacioni ushtarak. Gjenerali amerikan Krulak të vepruarin kompleks në mjedis urban e ka përshkruar si “ **Three Block War**” ose **lufta me tre blloqe ku në një pjesë të qendres urbane një komandanti i duhet të kryejë veprime luftarake, në pjesën tjetër operacion stabiliteti dhe në tjetrën shpërndarje ndihmash humanitare te gjitha keto gjatë një misioni të vetëm**. Komandanti duhet ti bëjë të gjitha përpjekjet për të parë qytetin jo vetëm në perspektivën e forcave tona dhe në perspektivën e forcave armike, por edhe në perspektivën e banorëve të tij.

Në PZL-në aktuale Zona e Interesit (ZI) në hapin e parë përcaktohet si një zonë gjeografike nga e cila kundërshtari ka aftësinë të rrezikojë përbushjen e misionit të forcave tona, por në përcaktimin e ZI-së në mjedis urban arkitektura urbane, infrastruktura sociale dhe fizike, dhe popullata janë entitete që kanë lidhje fizike, ekonomike, politike, sociale dhe kulturore.

Përcaktimi i ZI urbane duhet të marrë në konsideratë mënyrën se si këto lidhje të shumta mund të influencojnë përbushjen e misionit brenda ZO. Dy mënyra që plotësojnë njëra tjetrën sugjerohen për të menaxhuar këtë detyrë në dukje shumë të vështirë. *E para* është e bazuar në një **analizë të dendësisë**<sup>16</sup> së pikave të zgjedhura brenda ZO-së urbane, ZI-së dhe hapësirës së luftimit. *E dyta* i kushton vëmendje **analizës së lidhjes** që ekziston midis komponentëve primare të qytetit: ndërtesat, infrastruktura, dhe grupet e popullatës dhe terrenit nëntokësor.

E para siguron një mjet për të karakterizuar dhe dhënien e një rëndësie relative të elementëve në një zone urbane heterogjene. Ndërsa mënyra e dytë e përcaktimit të informacionit më tepër kritik është për të identifikuar lidhjet më të rëndësishme të misionit midis elementëve. Varësitë e ndryshme mund të jenë një burim i lidhjeve produktive ose shkak i një pastabiliteti. Duke filluar të kuptojmë se cilat lidhje janë më të rëndësishme lejon identifikimin e çështjeve të rëndësishme për të përbushur kërkesat e zbulimit.

---

<sup>16</sup> Për referencë lexo artikullin e Russell Glenn, “Urban Combat is complex”, botim i RAND.



Qëllimi i PZL-së në hapin e II-të është përshkrimi i zonës së operacionit me qëllim *1) familjarizimin e ushtarakut me mjedisin në të cilin do të veprojnë me të marrë misionin dhe 2) të ndihmojë shtabin të përcaktojë se si ky mjedis do të ndikojë operacionet tona dhe ato të armikut.* Tipet e terrenit që studiohen në doktrinën aktuale janë relativisht të lehtë duke përdorur mënyrën e zakonshme të analizës ushtarake të terrenit. Çka është më e rëndësishme në këtë fazë është armiku i cili është lehtësisht i identifikueshëm kur në ZO nuk ka prezencë civile.

Duke parë aftësinë e popullsisë për të ndikuar në operacionet ushtarake në një llojshmëri mënyrash, sugjerohet se një analist zbulimi që kryen PZL për operacione urbane duhet të përqëndrohet tek banorët e qytetit.

Çdo diskutim për popullsinë e një qyteti kërkon një vështrim të dyanshëm. Zhvillimi i një pamje të qartë të popullsisë së një qyteti kërkon përcaktimin e attributeve kryesore të tilla si statistika të moshës, pasurisë, gjinisë, etnisë, fesë dhe punësimit. Grumbullimi i këtij informacioni dhe raportimi i rëndësishëm së tij quhet **analizë demografike**. Përbërësi i dytë **zbulimi kulturor** përshkruan procesin me të cilin informacioni kulturor – preferencat e ushqimit, traditat, vlerat, mardhëniet dhe rivalitetet ndërmjet grupeve të ndryshme të popullsisë kanë të bëjnë me informacionin demografik i cili zbulon karakteristikat e brendshme të një popullsie me të cilat do të veprojnë forcat tona. Analiza demografike përshkruan *çfarë* kushtesh ekzistojnë. Zbulimi kulturor i kushtohet përshkrimit se  *pse* ekzistojnë këto kushte.

Gjatë hapit të tretë të PZL-së, vlerësimi i armikut në mjedis urban është i vështirë. Një shumëllojshmëri elementesh aktivë, pasivë dhe të papërfshirë mund të ndikojnë në operacionet e forcave tona ose të armikut në çdo tip misioni në zonë urbane. **Mënyra e përdorur deri me tani ku oficerët e zbulimit siguronin informacion për personelin, pajisjet dhe taktikat e përdorura nga një armik i njohur nuk është më e mjaftueshme.** Në hapin e tretë së pari duhet të identifikohen elementët njerëzorë dhe të tjerë të cilët mund të “*dëmtojnë*”, “*ndërhyjnë*” ose *ndikojnë* në veprimet e forcave tona. Me i vështirë është përcaktimi i armikut. Tre përbërës janë të pranishëm në të gjithë materialet doktrimore: *Armiku zotëron kapacitetin për të shkaktuar dëme; Armiku ka qëllimin për të*

*shkaktuar dëme; Ekziston gjithmonë një pikë e dobët që dëmtohet tek forcat tona.*

Për efekt të percaktimit të armikut dhe kategorizimit të popullsisë në *shkallën e interesit relativ* do të percaktohet si : *Një kundërshtar që ka aktualisht kapacitet dhe qëllime që të ndikojnë negativisht në kryerjen e misionit duke shfrytëzuar pikat e dobëta të forcave tona.*

Vend për diskutim ka ndryshimi që ka ndërmjet qëllimit dhe interesave të pjesëve përbërëse të popullatës. **Interesi** percaktohet si një motiv shtytës për ndjekjen e një aktiviteti, ndërsa **qëllimi** percaktohet si mënyra e zgjedhur për përmbushjen e interesave. Ndryshimi ndërmjet interesit dhe qëllimit është i rëndësishëm për tu marrë në konsideratë kur vlerësohet mënyra e ndikimit të elementëve të ndryshëm të një popullate. **Interesat** ndikojnë tek **qëllimet**. Duke përdorur përkufizimet e mësipërme ,si kriter për vlerësimin e natyrës dhe domosdoshmërisë për çdo element të popullsisë ,duhet që analisti i zbulimit të vendosë çdo grup që identifikohet në hapin e dytë të PZL-së, në shkallën relative të interesit duke përdorur këto kategori: **Kundërshtar; Pengesa; Neutral; Bashkëpunëtor; Aleat;**

Në hapin e katërt të PZL-së tradicionale bëhet lidhja e njohurive mbi armikun me kufizimet dhe mundësitë që ofron terreni dhe moti në një zonë operacioni. Objektivi i këtij hapi është percaktimi i mënyrës së sjelljes së armikut në një situatë të dhënë. Një objektivi tjetër është identifikimi i Qendrës së Gravitetit<sup>17</sup>, “ **nyjes/ve të fuqisë dhe lëvizjes prej nga varet gjithçka**” si dhe mjeteve që do të duhen për të ndikuar tek ato , në interes të përmbushjes së misionit.

Zhvillimi i KV në operacion urban është gati i njëjtë me atë që bëhet në mënyrë tradicionale por më shumë sesa marrja në konsideratë e një armiku të njohur këtu konsiderohen të gjitha grupet e rëndësishme të identifikuara dhe vendosura në shkallën e interesit relativ.

---

<sup>17</sup> Terminologji e shpikur nga strategu ushtarak prusian Carl Von Clausewitz në librin ikonë të mendimit ushtarak perëndimor “On War”. Lexo për më shumë, Howard, M, **Clausewitz: A very short introduction** (2002), Oxford University Press, 2002, f.40.

## **KREU IV : ANALIZA E ZBULIMIT NË OPERACIONET E INTENSITETIT TË ULËT**

Në kreun e katërt përcaktohet se zbulimi nuk është një funksion statik por përkundrazi përgjatë spektrit të operacioneve roli i tij ndryshon. Në operacionet e intensitetit të ulët shërbimi i zbulimit është përbërësi kryesor i përpjekjes për të mposhtur një kundërshtar që vepron “nën radarin” e forcave të rregullta. Në këto lloj luftrash autori Xhon Nagël (Johm Nagle) në librin e tij “ *Të hash supë me thikë*” thotë se është më mirë ti bindesh kundërshtarët që të japin informacion rreth bashkëpunëtorëve të tyre se sa ti vrasësh ata<sup>18</sup>.

Sfida e analizës së zbulimit në OIU është që midis shumë gjërave që merren në shqyrtim ,për të kuptuar më mirë një problem të caktuar të shtruar për zgjidhje, ndikojnë edhe faktorë të tillë si *konteksti, evidenca, opsionet, rreziqet dhe treguesit*.

Për shkak se njerëz të ndryshëm mendojnë në mënyra të ndryshme rreth një çështjeje, kjo për faktin se secili ka këndvështrimin e vet të problemit, faktorët që duhen përfshirë në zgjidhjen e tij, mënyrën e vlerësimit të fakteve dhe parashtrimit të opsioneve dhe risqeve, e bën analizën e zbulimit të jetë një proces kompleks dhe si të tillë jashtëzakonisht të vështirë.

Të pasurit tendencë është padyshueshmërisht e lidhur me natyrën njerëzore dhe për këtë përbën përherë një rrezik në gjykimin analitik<sup>19</sup>. *Ku* dhe për *Kë* bëhet analiza e zbulimit, përbën një diferencë të madhe në efektivitetin e saj. Për më shumë, ndryshimet teknologjike janë duke ndryshuar mënyrën se si është bërë, ku është bërë edhe nga kush është bërë. Kufiri midis asaj se çfarë është zbulim i nivelit strategjik ose kombëtar më atë të nivelit taktik është ngushtuar shumë.

Të menduarit kritik është çelësi për një analizë zbulimi efektive. Autori David Moore shprehet se “ *Një nga perceptimet më*

---

18 Nagl, J, vep.cit, f. 93.

19 Odom, W, (2008), **Intelligence Analysis**, *Intelligence and National Security*, 2008, Vol. 23, Nr.3, f.320

*të mëdha që bën dallimin midis oficerëve të zbulimit me politikanët është se politikanët tentojnë të jenë optimistë dhe besojnë se mund të bëjnë gjithçka, ndërsa oficerët e zbulimit tentojnë të jenë skeptike duke ditur se ekzistojnë pak gjëra që dihen me siguri”.*<sup>20</sup>

Një mënyrë që ndjekin analistët për të kufizuar këtë paqartësi është duke ndërtuar supozime mbrojtëse ndaj fakteve ekzistues. Në nivelin bazë këto supozime bazohen në **besueshmërinë** (a mund të besohet), **lidhjen** (a ka fakti lidhje më çështjen në diskutim) dhe **bindjen** (sa e aftë është të bindë se i përgjigjet pyetjes së dalë).

Mendimi kritik është mburoja që i shërben analistit për të mos rënë pre e gjykimeve të shpejta dhe gabuara. Të menduarit kritik është aftësi që fitohet nëpërmjet edukimit special dhe përvojës. Por që të jetë efektive, ajo duhet praktikuar shpesh dhe kudo.

Zbulimi ushtarak i angazhuar në operacionet e intensitetit të ulët ka pak gjëra të përbashkëta me operacionet konvencionale. Në operacionet e intensitetit të ulët puna e analistëve të zbulimit ngjan më shumë me punën që zhvillon policia në hetimin e grupeve dhe bandave kriminale. Matricat e shoqërimit, analizave e rrjeteve, analiza kulturore, gjenealogjia, analiza e modelit të ngjarjeve, analiza e modelit të gjuhës, analiza e rrjedhës së trafikut dhe analiza e transaksioneve financiare janë mjete të policisë të cilat janë padiskutim të pandashme për zbulimin në operacionet e intensitetit të ulët.<sup>21</sup>

## **KREU V: ZHVILLIMI E MODERNIZIMI I KAPACITETEVE ZBULIM PËR OPERACIONET OIU**

Objekti i **kreut te peste** është kompania e rikonicionit në strukturën e Forcave Tokësore ku vëmendja dhe analiza do të përqëndrohet se sa është në gjendje kjo kompani të realizojë

---

20 David Moore, *Critical thinking and Intelligence Analysis*, (Washington DC: Joint military Intelligence College, May 2006). f. x

21 Grau L, (2004), *Something Old, Something New: Guerillas, Terrorists, and Intelligence Analysis*, *Military Review*, 2004, Vol.4, Nr.4, f.43

misionin e detyrat në mbështetje jo vetëm të operacioneve të intensitetit të ulët por në të gjithë spektrin e operacioneve ushtarake. Gjithashtu në këtë kre jepen edhe rekomandime për ndryshimin organizativ e strukturor të saj, duke marrë si shembull ushtritë më të përparuara të vendeve të NATO-s.

